



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:120593
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05873183

CAP.nr.412/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren Nora Bllaca Dula, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit J.P nga P....., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson S.K, avokat nga Prishtina, ndaj debitorit Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Arsimit Komuna e Prishtinës, objekt i përmbarimit kërkesë në të holla, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, CPC.nr.58/2021 të datës 14.09.2022, me datë 25.06.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit J.P nga P....., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, CPC.nr.58/2021 të datës 14.09.2022, VËRTETOHET

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar, CPC.nr.58/2021 të datës 14.09.2022, ka vendosur si në vijim: “ *REFUZOHET propozimi për lejimin e përmbarimit të kreditorit J.P, i ushtruar në këtë gjykatë me datë 12.03.2021, sipas dokumentit përmbarues - Vendimit të Inspektoratit të Punës 01Nr./08-801/2020 të dt.10.08.2020, si i pabazuar*”.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim drejtuar Gjykatës së Apelit, që ta aprovoj ankesën si në propozim të ankesës.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtuar debitori.

Gjykata e Apelit, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP) dhe gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori J.P nga P....., përmes të autorizuarit të saj, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit Komuna e Prishtinës, Drejtoria e Arsimit, në bazë të dokumentit përmbarimor Vendimit të Inspektoratit të Punës 01Nr.08-801/2020 të dt.10.08.2020, mbi bazën e të cilëve ka kërkuar që të lejohet përmbarimi i vendimit në fjalë ashtu që të detyrohet debitori t'ia paguaj kreditorit në emër të shpërblimit jubilar në shumën prej 203.03€.

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit me aktvendimin CPC.nr.58/2021 të datës 14.09.2022, ka refuzuar propozimin për lejimin e përmbarimit si të pabazuar duke vendosur me decidivisht sikur në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata ka theksuar se propozimi për përmbarim është i pa përshtatshëm për përmbarim sepse në dispozitivin e vendimit e vendimit, përkatësisht dokumenti përmbarimor nuk është përcaktuar shuma të cilën debitori i përmbarimit duhet ta përmbushë ndaj kreditorit të përmbarimit por vetëm në mënyrë të përgjithësuar është obliguar punëdhënësi të bëjë pagesën e shpërblimit jubilar, pa asnjë specifikim të shumës që duhet kompensuar. Për mënyrën e vendosjes i është referuar dispozitës së nenit 6.3, 22, 27 paragrafi 1 dhe 44.3 të LPP-së.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar pavarësisht se aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, as në shkelje tjera të pretenduara, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, por e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Gjykata e Apelit ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të kreditorit së aktvendimi i atakuar nuk përmban fare arsyen e refuzimit të propozimit, se pse ai propozim është refuzuar, në cilat prova dhe fakte dhe mbi cilën bazë juridike është i bazuar ai refuzim, sepse gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, ngase nga provat në shkresat e lëndës ka gjetur se dokumenti përmbarimor nuk i plotëson kushtet ligjore për përmbarim, konform dispozitave ligjore në fuqi, andaj sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret dokumenti përmbarimor është i papërshtatshëm për përmbarime edhe nga fakti se me nenin 27 të LPP, në mënyrë shprehimore është paraparë se *“dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Në bazë të nenit të sipërcituar del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë

dokumentin përkatës përbarimor të papërshtatshëm për përbarim. Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se dokumenti përbarimor-Vendimi administrativ i Inspektoratit të Punës, 01Nr.08-801/2020 të dt.10.08.2020, i njëjti në dispozitiv nuk e përmban shumën e detyrimit, e që nuk dihet se si do të ekzekutohet një vendim i tillë. Në këtë drejtim vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e refuzuar propozimin për përbarim të kreditores.

Po ashtu, kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, duke zbatuar drejt dispozitat ligjore, dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se "Në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual".

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.412/2024, datë 25.06.2024

Gjyqtarja individuale
Nora Bllaca Dula d.v